

Data 12/11/2020

STATUT  
I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar  
"GANT 1"SHPK

Ne respektim te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare „ndryshuar me ligjin 129/2014, ligjit 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", aktin e themelimit,:  
Shoqëria themelohet nga ortaket :

1. **GANT CONSTRUCTION SHPK me NIPT K62805404K** i perfaqesuar nga administratori Eugert Bregu, shtetas Shqiptar, lindur me 30.06.1991 ne Fier , me ID nr J20630081N , banues ne Tirane, Komuna e Parisit, Rruga Haxhi Kika
2. Tregti DPI **SHPK me NIPT M02005010C** i perfaqesuar nga administratori Carlo Corrubulo, lindur ne Firenze Itali me 27/04/1956 I identifikuar me nr id. AZ0144564 dhe banues ne Via umberto primo Biancamano d2 .
3. Z.Alessandro Secondo Zorgniotti, lindur ne Torino Itali me 27/05/1974 I identifikuar me nr id. YA6828347 dhe banues ne Tirane Komuna e Parisit Kompleksi Kika.
4. Z. Gjon Radovani lindur ne Scutari Shqiperi me 08/03/1961 I identifikuar me nr id. C4X699ZFN dhe banues ne TiRANE Rruga Barrikada Pl 8 shk 2 kt 5 ap 18.

**KREU I**

**Neni 1**  
**Emertimi**

Shoqeria emerohet "GANT 1"SHPK, ajo eshte person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (e cila ketu e me poshte do te quhet "Shoqeria").

**Neni 2**  
**Personaliteti juridik**

Shoqëria "GANT 1"SHPK, nga këtu e më poshtë referuar si shoqëria, e fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).  
Shoqëria është person juridik shqiptar, që cila zhvillon aktivitetin në përpunhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare" dhe këtë Statut.

### **Neni 3**

#### **Selia**

Shoqeria e ka seline kryesore ne Berat,Ura vajgurore Pashalli , me numer pasurie 509/16, Zona Kadestrale Nr.2881, Volumi 2, Faqe 159, ne Fshatin Pashalli, Berat. Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim e asamblese se ortakeve.

### **Neni 4**

#### **Objekti i veprimtarise**

Aktivitet ne fushen e ndertimit dhe prodhimit, perpunim dhe prodhim gelqere, import – eksport te gelqeres dhe produkteve te ndryshme. Shit-blerje, import – export i sherbimeve dhe produkteve te ndryshme. Shoqeria mund te kryeje edhe veprimitari te tjera ndihmese te cilat mbeshtesin arritjen e qellimit te saj kryesor ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

### **Neni 5**

#### **Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKR.

**KREU II  
KAPITALI**

### **Neni 6**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 100 000 (një qind mijë lekë).

Ortaket e shoqerise jane :

1. **GANT CONSTRUCTION SHPK** me **NIPT K62805404K** i perfaqesuar nga administratori Eugert Bregu, shtetas Shqiptar, lindur me 30.06.1991 ne Fier , me ID nr J20630081N , banues ne Tirane, Komuna e Parisit, Rruga Haxhi Kika me 50 % te kuotave.
2. Tregti **DPI SHPK** me **NIPT M02005010C** i perfaqesuar nga administratori Carlo Corrubulo, lindur ne Firenze Itali me 27/04/1956 I identifikuar me nr id. AZ0144564 dhe banues ne Via umberto primo Biancamano d2 me 23.333 % te kuotave.
3. Z.Alessandro Secondo Zorgniotti, lindur ne Torino Itali me 27/05/1974 I identifikuar me nr id. YA6828347 dhe banues ne Tirane Komuna e Parisit Kompleksi Kika me 13.333 % te kuotave.
4. Z. Gjon Radovani lindur ne Scutari Shqiperi me 08/03/1961 I identifikuar me nr id. C4X699ZFN dhe banues ne TiRANE Rruga Barrikada Pll 8 shk 2 kt 5 ap 18 me 13.333 % te kuotave.

Kontributi i ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

**Neni 7**  
**Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te një eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakeve te Shoqerise në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratori, në përpjekje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

**Neni 8**  
**Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III  
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9  
Organi Vendimmarres

Drejtimi dhe administrimi i shoqërisë bëhet nëpërmjet organeve të saj që janë:

- Administratori.
- Asambleja e Përgjithshme e ortakeve

Ortaket e shoqerise jane organi vendimares i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaket e shoqerise , vendosin për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortakeve te Shoqerise mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## Neni 10

### Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme e ortakeve te shoqerise vodos për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme e Ortakeve te Shoqerise vendosin , për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve

- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

### Neni 11 Administratori

- **Administrator i shoqerise eshte z. Selim Bregu**, atesia Barjam, shtetas Shqiptar, lindur më 05.06.1968 në Fier dhe banues në Tirane , madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me karte identiteti nr.G80506023D.

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.


Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm

### Neni 12 Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Ortakeve te Shoqerise;
- b) përfaqësojë shoqerinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Ortakeve te Shoqerise për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e Ortakeve te Shoqerise edhe ne rastet kur :



sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqerinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave te te gjitha niveleve, zyrave te tatim taksave, autoritetet doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori angazhon shoqerinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrëthanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

### **Neni 13** **Pergjegjesite e administratorit**

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortakeve te Shoqerise që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe Ortakeve te Shoqerise që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesht;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;


c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të



vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

**KreuIV**  
**Viti finanziar ekspertet**

**Neni 14**  
**Viti Financiar**

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtmisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

**Neni 15**  
**Prishja dhe likujdimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelin e saj
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit
- ç) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombetare te Regjistrimit”;
- d) me vendim te gjykates.

Ne kete rast Ortakeve te Shoqerise merr vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper“.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakeve te Shoqerise Nëse Ortakeve te Shoqerise nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19**  
**Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

**Neni 20**  
**Baza ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 21**  
**Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptar.

**"GANT 1"SHPK**  
**ORTAKET E SHOQERISE**

Gant Constuction Shpk



Alessandro Zorgniotti

*Alessandro Zorgniotti*



Gjon Radovani

*Gjon Radovani*

Tirana 12.12.2020

PERKTHEU

**Eriselda Bregu** shtetase shqiptare e datelindjes 18.08.1991 ne Fier mbajtëse i dokumentit të identifikimit karte identiteti me nr.J15818070W,me adresë Rruga Haxhi Kika nd 5 ap 6 Tirane.



